

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

Inpress

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L52122014L

NUIS/NIPT

Ish Blloku i Magazinave të Tregtise, Rruga Siri Kodra

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0682069861

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@inpress.al

E-mail

Administrator Erald Dervishi

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2024/06/11

Data (viti/muaji/dita)

+355682069861

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-07760-06-03-2024

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

22729430

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2024/07/04

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Mallra

Data e zhvillimit të procedurës

2024/07/04

Numri i njoftimit

CN/83994/06032024

Kodi CPV

22900000-9

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 110 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; si dhe Vendimit nr. 285, datë 19.5.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

□

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Të nderuar zotërinj,

Në vijim të të procedurës së prokurimit publik të Autoritetit Kontraktor OSHEE Group sh.a., me objekt: “Shtypshkrime dhe materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a, e ndarë në dy lote - Loti i II-të: “Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave”, dhe me Fond limit: 22,729,430 (njëzet e dy milion e shtatëqind njëzet e nëntë mijë e katërqind tridhjetë) Lekë pa TVSH, publikuar me datë 04.06.2024, brenda afatit 10 ditor nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen e internetit të APP-së, të parashikuar nga pika 1 e nenit 110, e Ligjit Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, mëposhtë Ju parashtrajmë kundërshtitë tona për dokumentet e tenderit dhe arsyet ligjore ku bazohen këto kundërshti:

* * *

I.

Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

1. Në pikën 2.4.5 “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

“2.4.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

?Makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me permasa më të mëdha

?Makinë qepse me pe me permasa 35x25

?Makinë prerje me permasa 80x110

?Makinë qepese me tel

?Thikë një anëshe

Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.

Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjetër të fitimit të pronësive sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjetër disponimi të njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqesin kontratën e qirase ose huapërdorjes të lidhur mes paleve, me afat kohezgjatje minimalisht dy muaj vlefshmeri, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjetër të fitimit të pronësive sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjetër disponimi të njohur nga ligji).

Per te permbushur kriterin e mesiperme ne fazen e ofertimit, operatori ekonomik duhet deklaroje disponimin e makinave ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces perkatese te DST.

Sqarim : Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe

dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).”

Kriteri i veçantë i kualifikimit: OE të disponojë ”Makinë shtypi 50x70 5 C + llak, ose me përmasa më të mëdha”, bazuar në kërkesat e autoritetit kontraktor për mallrat e prokuruarra është i) diskriminues, ii) jo – në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që po prokurohet, dhe iii) nuk do të duhet të konsiderohet i përshtatshëm, dhe për këtë arsye do të duhet të ndryshohet.

II.
Përshkruani rrethanat e faktit.

? Në pikën 2.4.7. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit – Loti II”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

”2.4.7. Në datën dhe orën e hapjes së tenderit duhet të paraqitet në cilësinë e mostres:

? Një kuti kartoni me përmasa 40x28x18 ;

? Një Kutë për ruajtje të përhershme me përmasa 40x28x18;
sipas specifikimeve të përcaktuara në DST.”

? Në Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve teknike”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

“II-Specifikimet teknike të materialeve të arkivës Loti i Dytë:”

“1. Kutë kartoni 40 x 28 x 18 cm. Materiali që do të përdoret do të jetë karton i ngurte me përmasa 78x109, I paprere, me peshë 2000 gr/m². Do të ketë dy kapake, të gjitha këndet do të jenë 90 grade, të gjitha brinjët do të lidhen me beze. Kjo veshje behet për të siguruar ngjitjen. Kutia të jetë me suprinë 80 gr/m² me ngjyrë. Vendoset edhe një lidhese për terheqje.

17. Kutë për ruajtje të përhershme me përmasa 40x28x18- Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramaturë 620 gr/m² që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin. Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.”

Në specifikimet teknike të artikujve / produkteve që kërkohet të paraqiten mostra / modele nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, përcaktohet edhe gramatura respektive e letrës apo kartonit, por duke mos vendosur asnjë marzh dhe tolerancë +/- në gramaturë, përse i përket peshës së letrës dhe kartonit të mostrave të kërkuara në DST.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.

Të nderuar zotërinj,

Në DST kërkohet që: OE pjesëmarrës të vërtetojnë disponimin e një i) ”Makinë shtypi 50x70 5 C + llak, ose me përmasa më të mëdha;

Nuk ekziston asnjë logjikë dhe nevojë teknike, përse një OE pjesëmarrës do të duhet të disponojë 1 pajisje shtypi të përmasave 5 Color + llak. Për realizimin e produkteve / mallrave të kërkuar në DST

nga AK, teknikisht do të mjaftonte vetëm 1 (një) makineri / pajisje shtypi "Makinë shtypi 50x70 4 Color + llak". Si rrjedhojë, disponimi i një pajisje të përmasave 50x70 5Color + llak është i panevojshëm dhe tërësisht i ekzagjeruar pasi:

? Është e vërtetë që në DST dhe specifikimet teknike për prodhimin e disa prej mallrave të prokuruar kërkohet që ato të jenë në 5 (pesë) ngjyra + llak;

? Por është gjithashtu mëse e vërtetë, që një pajisje / makinë shtypi 50x70 4C + llak, mund të realizojë teknikisht me vetëm 1 (një) kalim, jo vetëm 5 ngjyra por edhe më shumë, pasi teknikisht nga kombinimi i 4 seksioneve të Makinerisë së shtypit, që korrespondojnë me numrin e ngjyrave të secilit seksion, mund të prodhohen të gjitha ngjyrat ekzistuese njëherazi.

? Si rrjedhojë, teknikisht do të mjaftonte vetëm disponimi i 1 (një) makinerie / pajisje shtypi "Makinë shtypi 50x70, 4 C + llak, për prodhimin e mallrave të kërkuar në DST dhe realizimin e kontratës.

Nga sa mësipër, bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartpërmendura, gjykojmë se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, pra në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorohet në zbatim të neneve 36 dhe 77 të LPP-së.

Synimi bazë i autoritetit kontraktor duhet të jetë vërtetimi nëse subjektet ofertues zotërojnë ose jo kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës, duke lehtësuar edhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike në procedurë, pasi ky është dhe qëllimi i ligjit dhe rregullave të prokurimit publik.

Kërkesa e Autoritetit Kontraktor, që operatori ekonomik duhet të disponojë pajisjet/makineritë "...Makinë shtypi 50x70 5 C + llak",... është një kërkesë abuzive dhe e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, si dhe ul ndjeshëm konkurrencën.

Si rrjedhojë, kriteri i veçantë kualifikues: "Operatori ekonomik duhet të disponojë "...Makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me përmasa më të mëdha", do të duhet të ndryshohet, duke vendosur si kriter kualifikues vetëm disponimin e 1 (një) makinerie / pajisje shtypi "Makinë shtypi 50x70 4 C + llak

Për më tepër, në vitet e fundit, Komisioni i Prokurimit Publik ka marrë disa Vendime pikërisht në lidhje me këtë kriter kualifikues (Për referencë, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik K.P.P 272/2020, datë 24.07.2020), me anë të së cilës KPP ka pranuar plotësisht, se kriteri "...Makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me përmasa më të mëdha" është një kriter i ekzagjeruar dhe i kundraligjshëm, dhe do të mjaftonte një "Makinë shtypi 50x70 4 C + llak", për realizimin teknik të pesë dhe më shumë ngjyrave.

Për sa mësipër, në zbatim të nenit 36 dhe 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, ky kriter teknik është "...diskriminues dhe pengues, ...nuk është në përpjestim me natyrën kontratës që do të prokurorohet,..." si dhe "...jo i lidhur ngushtë me aftësinë e zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik", dhe për këtë arsye do të duhet të ndryshohet.

* * *

Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.

Të nderuar zotërinj,

Nisur nga fakti që në specifikimet teknike të përcaktuara në DST, të artikujve / produkteve që kërkohet të paraqiten mostra / modele nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, nuk përcaktohet asnjë marzh dhe tolerancë +/- në gramaturë...

...duke marrë gjithashtu në konsideratë që Komisioni i Prokurimit Publik me anë të disa vendimeve të tij ka skualifikuar operatorë ekonomikë pjesëmarrës pasi mostrat e dorëzuara prej tyre kishin një diferencë në peshë minimale më të vogël, apo më të madhe se ajo e përcaktuar në DST,...

...por ka pasur raste gjithashtu, që Komisioni i Prokurimit Publik me anë të disa vendimeve, ka

konsideruar të rregullt ofertat e disa operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, pavarësisht faktit se pesha e letrës dhe/ose kartonit nuk ishte ekzaktesisht sa ajo e kërkuar dhe e përcaktuar në DST...
...për të eliminuar / shmangur çdolloj vendimarrje diskrecionale dhe të pambështetur në kritere teknike (në të 2 rastet e lartpërmendura) nga ana e AK dhe KPP mbi këtë kriter teknik të përcaktuar në DST,...

...kërkojmë të përcaktohet edhe marzhi dhe toleranca +/- në gramaturë, përsa i përket peshës së letrës dhe kartonit të mostrave të kërkuara në DST, si dhe nëse ekziston një tolerancë e tillë, cila / çfarë tolerance +/- është e pranueshme nga AK...

Për sa mësipër, në zbatim të të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ky kriter teknik lë vend për vendimarrje diskrecionale dhe të pambështetur në kritere objektive dhe teknike nga ana e AK dhe KPP, dhe për këtë arsye shtojca 5 “Formulari i Specifikimeve teknike”, të Dokumentave Standarte të Tenderit do të duhet të ndryshohet, duke përcaktuar dhe saktësuar marzhin dhe tolerancën +/- në gramaturë, përsa i përket peshës së letrës dhe kartonit të mostrave të kërkuara në DST

* * *

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

Jo

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

info@inpress.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Erald Dervishi